

PROCESVERBALI PËR PLANIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2028.

Datë 25 gusht 2025 ora 12:00

Salla e Këshillit Bashkiak

Këshilltari E.Mitre: Përshendetje ju falenderoj që jeni prezent në këtë takim, në emër të komisionit të mirëqënies sociale, barazisë gjinore dhe kryesisë të Këshillit bashkiak, ju të gjithë jeni në dijeni se po diskutojmë planin e arsimit parauniversitar të hartuar nga Bashkia në bashkëpunim me Smartprocess është Shqota Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë. Prezantimin e detajuar do na i bëjë znj.Rudina.

Rudina Lako: Përshëndetë për ata që nuk më njohin unë jam Rudina Lako, këshilltare e kryetarit për arsimin parashkollor, Jemi duke diskutuar planin e arsimit parauniversitar ku përfshihen kopshtet, shkollat. Bashkia ka marrë në vartësi shërbimin për arsimin parashkollor në mënyrë totale. Duam të diskutojmë me ju mendimet tuaja, propozimet në lidhje me planin, Ju lutem të jeni sa më shumë aktive dhe kjo ndikon edhe tek shërbimet. Bashkia Korçë e sheh arsimin parauniversitar si një të drejtë për gjithë fëmijët. Vizioni i planit të garantohet akses i barabartë dhe përfshirje e plotë në arsimin parauniversitar për çdo fëmijë për të modernizuar shërbimin në shkollat dhe kopshte. Një informacion të shkurtër, Bashkia Korçë përfshin 8 njësi administrative Korçën, Voskop, Voskopojë, Bulgarec, Leksa, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë, kemi një ndërhyrje të zonave rurale dhe urbane kërkon të kemi një planifikim sa më të detajuar dhe ofrim sa më të mirë të shërbimit për të garantuar akses të barabartë. Këto janë disa të dhëna të shkëputur nga census dhe ne kemi shkuror nga census dhe ne kemi shkëputur pjesën për të cilën jemi mbledhur që janë grupmoshat nga 0-19 vjeç. Arsimi parashkollor kemi nr e kopshteve 49 duke përfshirë edhe zonat rurale, tek arsimi parashkollor futim edhe klasat përgatitore, kemi Bulgarec 11, Voskop 5, Voskopojë2 , Vithkuq 3, Mollaj 4, Drenovë 5 dhe Leksa fatkeqësisht është mbyllur kopështi për shkak se nuk ka fëmijë. Për 3-6 vjet kemi 66. 27 % të fëmijëve që ndjekin kopështin, vetëm 66.27 % ndjekin arsimin parashkollor. Nëse e cojmë në kopësht me ushqim detyrohet një pagesë për ushqimin e fëmijës. Këto janë të dhëna nga census që të gjithë mund t'i marrin dhe mos bihem në përsëritje, vlerësimin ka disa indikatorë mbi të cilën bëhet dhe është bërë në bazë të një metodologjie që ka dy kritere bazë, pastaj ka nënkritere por bazë ka emergjenca e ndërhyrjes sipas vlerësimit që i bëhet insitucionit. Objektivi 2 të realizohen dweri në fund të vitit 2028 investimet prioritare, përpunime, riskonstruksione të paktën 26 institucione për arsimin parauniversitar. Zhvillimi i plotë i fëmijëve përmes edukimit cilësor në një system gjithë përfshirës. Deri në fund të vitit 2028 të forcohet bashkëpunimi shkollë-familje-komunitet përmes aktiviteteve gjithëpërfshirëse. Plani patjetër është i shoqëruar me aktivitete të arsimit parashkollor, bazë, e mesme. Tani është fjala juaj, ju faleminderit.

Këshilltari E.Mitre: Duke parë dhe kërkesën e prindërve për rregjistrimin efëmijëve për klasat përgatitore, mund të bëhet një shtim i këtyre klasave, e kemi ne kapacitetin?

Rudina Lako: Ky është një problem që e kemi me gjithë dretjuesit e shkollave, sepse kur janë hapur klasat përgatitore, janë hapur për fëmijët që ktheheshin nga emigrimi, nuk dinin gjuhën

dhe për fëmijët 5-vjeçare u krijuan këto klasat për tu bërë gati për klasat e para, më pas kjo devijoi nga qëllimi kryesor dhe ideja është se vetë prindërit bëjnë dy vjet në kopësht dhe në grupin e tretë kalojnë në klasa përgatitore. Duke qënë se progarimi i klasave përgatitore me grupin e tretë është i njëjtë nuk ka pse bëhet ky ndryshim, kjo klasa të ekzistojnë por jo kështu siç po funksionon sepse klasat përgatitore janë tejet të mbushura dhe kopshtet i kemi në grupe të vogla. Unë kam bërë takim edhe me drejtuesen e DRAP nëse mund të bihem në një ujdi, por ishte moemnti që ishte kohë zgjedhjesh.

Këshilltare E.Mitre: Të paktën të ulet numri tek klasat përgatitore.

Këshilltare A.Taho: Unë do bëja një sygjërim nëse më lejoni, ne kemi disa kopshte në qytet që i kemi të tej mbushur dhe nga ana tjetër kemi disa kopshte që rrezikojnë. Di gjë disa fëmijë të zonave rregjistrohen në kopshte larg dhe kemi kopshte të tej mbushura dhe bosh. E dyta e kam dëgjuar nga komuniteti më shumë kemi dy çerdhe që rezultojnë të tej mbushura edhe shumë problematika besoj për shkak se kërkojnë më shumë kujdes pasi janë fëmijë të vegjël dhe besoj se këtu Bashkia duhet të krijojë hapësira të reja në lidhje me ambientet për këta fëmijë.

Rudina Lako: Për pjesën e parë vetë ligji e përmban se numri i fëmijëve në kopshte është maksimumi 25.

Këshilltare A.Taho: Ne sot nuk e kemi luksin për të plotësuar numrin 25, ne kemi mundësi që së bashku të kemi më pak fëmijë tek kopshtet e mëdha dhe të mbushim kopshtet që kanë pak.

Këshilltare E.Mitre: Këtu hyn edhe prindi.

Rudina Lako: Për pjesën e çerddes tek ky plan nuk futen çerdhet sepse është thjesht arsim parauniversitar. Edhe grupi i tretë i çerddes do hyjë në arsim me një lloj kurikule sepse nuk do jenë thjesht institucion përkujdesje por do kalojë edhe edkuim.

Qyetetaria: Jam drejtuese e kopështit "Lulet e Vogla", do doja kjo që tha Anxhela të shikohej ndarja siç tha Anxhela, ne nuk kemi asnjë rregjistrim, i kanë marrë gjithë fëmijët 2 kopshtet e qytetit, si do e shtyjmë?

Përderisa kemi një ligj është gjynah të tejmbushësh grupin e parë me 40 fëmijë përshebull. Unë them se duhet të ketë një plan lidhur me këtë problematikë, sepse klasa jote është për 17 ti pse e çon 30 numrin, e mbingarkon?

Tjetra për pjesën e bazës materiale do doja që kur të zgjidheshin të kishte një prind atje apo mësues sepse na vijnë shumë gjëra që nuk na hyjnë në punë.

Rudina Lako: Në dijeninë time ju pregatisni një listë se çfarë ju duhet.

Qyetetaria: Po por lista është shumë e përgjithshme, të vendosim kryq të gjërva që na duhen.

Këshilltare E.Mitre: Faleminderit Fabiola, po klajdi.

Këshilltar K.Pllaha: Nuk ka gjë sepse unë kam mundësi dhe nesër dhe të enjte për të bërë pyetje por kjo çështja që u shtrua këtu është me shumë rëndësi, nëse një kopësht nuk ka fëmijë dhe tjetri është i mbingarkuar me 35 kur duhen 25 atëherë kemi një shkelje.

Këshilltare E.Mitre: Nuk bëhet ndarja sipas demografisë sepse nëse bëhet kopshtet janë tamam.

Këshilltar K.Pllaha: Pse nuk bëhet?

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Prindërit dorëzojnë vërtetim banimi por ndodh që çojnë një kontratë qeraje ë 1-vjeçare kur e rregjistrojnë edhe në kopshtin ku do ai.

Këshilltare E.Mitre: Pse mos bëhet kjo që 1 mësuese që ka më pak nxënës të kalojë tek ai që ka më shumë?

Rudina Lako: Nuk ka ambiente, unë propozoj që të bihem dakort ta bëjmë me vendim të Këshillit Bashkiak sepse ne themi vendimmarrës kemi Këshillin Bashkiak sepse ne jemi ekzekutiv të mblidhemi të përcaktojmë kriteret dhe të jemi të gjithë të kënaqur edhe prindërit do bëjnë rezistencë sa do bëjnë por do e pranojnë sepse unë i them kam ligjin dhe mbrohem me atë. Çdo vit po shpikim metoda të reja si fëmijët të na rregjistrohen në zonat ku ju takon por Korça për hir të së vërtetës është por Korça për hir të së vërtetës është qytet o vogël ka njoje.

Këshilltar K.Pllaha: Znj.Lako kjo shprehja të mblidhemi, ky është konsultimi publik jemi mbledhur dhe tani nuk mund të themi ta bëjmë me vendim Këshilli kur t'i konsultimin publik e bën 3 ditë para mbledhjes, konsultimit publik merret dëgjohen nga ana e ekzekutivit, analizohet dhe thehen në objektiva futen në plani i veprimit. E bëni dot për 3 ditë?

Rudina Lako: jo nuk e bëjmë dot.

Këshilltar K.Pllaha: Planin nuk ka tregues të matshëm të mënyrës si realizohet, keni pasu një plan më parë keni sjellë një raport sa është realizuar?

Rudina Lako: Raportin ja u sjellim në dispozicion, përse i përket çështjes tjetër kjo është një dashamirësi midis nesh dhe drejtuesve.

Këshilltare A.Taho: Ndoshta nuk është momenti tani, unë nuk jam dakort që brenda këtyre tre ditëve të kemi një rregullore si mund ta quajmë dhe aq më tepër që ne sot nuk kemi përfaqësues të prindërve por jemi shumë pak, nuk duhet të nxitojmë por kjo për mua është një këmbanë alarmi dhe të ulemi të punojmë, që vitin e ardhshëm të sjellim një plan më të mirë.

Rudina Lako: Nëse do hyni më në thellësi të planit do shihni se ka shumë për arsimin

Këshilltar K.Pllaha: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Rudina Lako: Sa kohë kam unë në dispozicion nuk ka asnjë kërkesë që të ketë nga një fshat në fshat tjetër. Për pjesën e kopshteve private ne thjesht shohim dhe kontrollojnë por shifra nuk disponojmë.

Këshilltare E.Mitre: Fëmijët me aftësi të kufizuara janë të mbuluar të gjithë me mësuese ndihmëse, ose shërbimi psiko-social është funksional?

Rudina Lako: Me mësuese ndihmëse janë gjithë fëmijët të mbuluar në bazë të vlerësimit të komisionit por ka një problem me aftësi ndryshe që nuk janë të deklaruar, mësueset i kanë atje dhe kanë problematikë por unë nuk mund të vendos mësuese ndihmëse nëse ai nuk është i deklaruar, për shërbimin psiko-social kemi vetëm një psikologe për kopshtet brenda qytetit.

Këshilltare E.Mitre: Ka pyetje tjetër apo sygjërim?

Unë e kam ngritur porblemin e shtimit të 1 çerdhe tjetër dhe kam marrë përgjigje pozitive nga kryetari por ja Rudina sikur na hapi një dritë jeshile.

Rudina Lako: Kemi rënë dakort me kryetarin për gjetjen e një ambienti por brenda vitit nuk besoj se bëhet.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Diana me kuadrin ligjor që është në fuqi kemi mundur të bëjmë më të mirë, ndoshta dhe duke ju “përdorur” ju pak më shumë që atyre fëmijëve t’ju ofrojnë atë që meritojnë. Me këtë kuadrin e ri ligjor që do vendoset patjetër do i zbatojmë të gjitha, edhe për numrin e shtretërve, edhe për M2 që duhet të ketë për 1 fëmijë.

Rudina Lako: Besoj se jeni në dijeni edhe rregulloren e kemi hartuar edhe të kopështit edhe çerdhes jemi duke bërë rregulloret, jemi në përfundim do e diskutojmë edhe me ju për të krijuar një rregullore sa më të mirë.

Këshilltare E.Mitre: Ka pyetje tjetër apo sygjërim?

Nëse jo unë ju falenderoj, punë të mbarë në vazhdim sepse dhe ju filloni tani dhe Rudinës i uroj suksese!

Përmbledhje e rekomandimeve :

Këshilltare E.Mitre: Duke parë dhe kërkesën e prindërve për rregjistrimin efëmijëve për klasat përgatitore, mund të bëhet një shtim i këtyre klasave, e kemi ne kapacitetin.

Këshilltare E.Mitre: Të paktën të ulet numri tek klasat përgatitore.

Këshilltare A.Taho: Unë do bëja një sygjërim nëse më lejoni, ne kemi disa kopshte në qytet që i kemi të tej mbushur dhe nga ana tjetër kemi disa kopshte që rrezikojnë. Di gjë disa fëmijë të zonave rregjistrohen në kopshte larg dhe kemi kopshte të tej mbushura dhe bosh. E dyta e kam dëgjuar nga komuniteti më shumë kemi dy çerdhe që rezultojnë të tej mbushura edhe shumë problematika besoj për shkak se kërkojnë më shumë kujdes pasi janë fëmijë të vegjël dhe besoj se këtu Bashkia duhet të krijojë hapësira të reja në lidhje me ambientet për këta fëmijë.

Këshilltare A.Taho: Ne sot nuk e kemi luksin për të plotësuar numrin 25, ne kemi mundësi që së bashku të kemi më pak fëmijë tek kopshtet e mëdha dhe të mbushim kopshtet që kanë pak.

Qytetaria: Jam drejtuese e kopështit ”Lulet e Vogla” , do doja kjo që tha Anxhela të shikohej ndarja siç tha Anxhela, ne nuk kemi asnjë rregjistrim, i kanë marrë gjithë fëmijët 2 kopshtet e qytetit, si do e shtyjme?

Përderisa kemi një ligj është gjynah të tejmbushësh grupin e parë me 40 fëmijë përshembull. Unë them se duhet të ketë një plan lidhur me këtë problematikë, sepse klasa jote është për 17 ti pse e çon 30 numrin, e mbingarkon?

Tjetra për pjesën e bazës materiale do doja që kur të zgjidheshin të kishte një prind atje apo mësues sepse na vijnë shumë gjëra që nuk na hyjnë në punë.

Këshilltar K.Pllaha:, nëse një kopësht nuk ka fëmijë dhe tjetri është i mbingarkuar me 35 kur duhen 25 atëherë kemi një shkelje.

Këshilltare E.Mitre: Nuk bëhet ndarja sipas demografisë sepse nëse bëhet kopshtet janë tamam.

Këshilltar K.Pllaha: Pse nuk bëhet?

A.Taho Noshta nuk nuk është momenti tani, unë nuk jam dakort që brenda këtyre tre ditëve të kemi një rregullore si mund ta quajmë dhe aq më tepër që ne sot nuk kemi përfaqësues të prindërve por jemi shumë pak, nuk duhet të nxitojmë por kjo për mua është një këmbanë alarmi dhe të ulemi të punojmë, që vitin e ardhshëm të sjellim një plan më të mirë.

E.Mitre; Unë e kam ngritur problemin e shtimit të 1 çerdhe tjetër dhe kam marrë përgjigje pozitive nga kryetari por ja Rudina sikur na hapi një dritë jeshile

-Rregullore – plan për regjistrimin e fëmijëve në kopshte

Sekretari i Këshillit

Eva Naçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

Listëprezenca e konsultimit

“PLANI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2028”

Takim datë 25.07.2025 ORA 12:00

NR.	EMËR, MBIEMËR	E-MAIL	NËNSHKRIMI
1	turkela Tido	talo.turkela@gmail.com	
2	Marjona Sema	marjona.sema@gmail.com	
3	Diana Pino	diananarbo@gmail.com	
4	Gerda Shule	shulegerda@gmail.com	
5	Klajdi Pllaha	kpllecha@yahoo.com	
6	Beylçe Hoxha	Hoxha.beyle@gmail.com	
7	Ariela Zhupa	arielazhupa@hotmail.com	
8	Mimozë Saho	- - -	
9	Jankelo Isak	jankeloisak@gmail.com	
10	Emilde Hasa	emildahasagmail.com	
11	Viola Vesli	violaveshi@yahoo.com	
12	Rozë Droço	Rozë Droço@gmail.com	
13	Aida Manotri	aidamgdimanotri882@hotmail.com	
14	Meqi Kolec	meqi_kolec@hotmail.com	
15	Ola Sotir	ola.sotir18@gmail.com	

16	Marinela Anponi	marinela991205@gmail.com	
17	Eljona Qato	eljonastefo@gmail.com	
18	Liljana Hysolli	hysolli.liljana@yahoo.com	
19	Gentiana Mella	gencaqylaf35@gmail.com	
20	Folyola Btru	folyola.btru@gmail.com	
21	Fabjola Porodina	fabjolakosova3@yahoo.com	
22	Mimoza Kono	kopshtet34@gmail.com	
23	Manjola Brebicka	manjolatrebicka@yahoo.com	
24	Sonila Nake	sonilanake@yahoo.com	
25	Grusilola Mulla		
26	Xhensile Arifi	xhensilearifi@gmail.com	
27	Enkelejola Manka		
28	Senjela Zuni	senjela124@gmail.com	
29	Zija Bresha	jolabresha@baskiistorci.net	
30	Alfred Qarqay	11.S.H.M.A.C. p.p.g. mk.	



100
"L'esperienza di essere
in un luogo così moderno
e accogliente è stata
molto positiva. Grazie
a tutti per l'ospitalità
e per l'organizzazione."





ARSIMI CILËSOR DHE GJITHËPËRFSHIRËS

Qëllimi kryesor i kësaj sesi të punës është: modernizimi dhe
gjerësimi i arsimit cilësor.

5 pika kryesore:

- Modernizimi dhe gjerësimi i arsimit cilësor, modernizimi dhe
gjerësimi i arsimit cilësor në tërësi të arsimit.
- Të gjithë mësuesit të arsimit cilësor të jenë të kualifikuar.
- Të gjithë mësuesit të arsimit cilësor të jenë të kualifikuar.
- Të gjithë mësuesit të arsimit cilësor të jenë të kualifikuar.
- Të gjithë mësuesit të arsimit cilësor të jenë të kualifikuar.





Agenda de lucru a sesiunii de lucru

- 1. Deschidere
- 2. Prezentare
- 3. Discuție
- 4. Închidere

Se prezintă și se discută despre activitatea de lucru a unității de lucru, în vederea realizării obiectivelor stabilite în planul de lucru.

Se prezintă și se discută despre activitatea de lucru a unității de lucru, în vederea realizării obiectivelor stabilite în planul de lucru.